

VENDIM
Nr.787, datë 24.9.2010

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.399, DATË 27.3.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË
ANËTARËVE TË RREGULLT DHE TË ANËTARËVE TË PËRHERSHËM TË
AKADEMISË SË SHKENCAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.399 datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt, të anëtarëve të përhershëm dhe të anëtarëve të asociuar të Akademisë së Shkencave”.

b) Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e asociuar të Akademisë së Shkencave përfitojnë një shpërblim mujor, për titullin “Akademik i asociuar”, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha